



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data 01.03.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit",

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): shërbime të organizimit të festave-79954000-6, shërbime rekreative, kulturore dhe sportive-92,

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 108 500(dy milionë e njëqindë e tetëmijë e pesëqindë)lekë pa tvsh

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim", çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer nëpërmjet tre ofertave. Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të gjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në baz të mesatares së ofertave ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.727/2prot.,07.02.2023 .

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit (E HAPUR E THJESHTUAR) është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" nenin 49, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"nenin 11, pika 1, gërma b dhe neni 55.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshur, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 5, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 te DST).

3. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

4 Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kritere janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhdhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të ulët se 800 000 lekë pa tvsh.

. **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet: *Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 në zbatim të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2022 per secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

Kriterin e argumentojmë gjithashtu me faktin se shlyerja e detyrimeve të OE ndaj Bashkive ku ushtrojnë akritivitet është një kredencial dhe besueshmëri më shumë financiare që marëdhënia kontratuale e mundëshme, midis OE dhe bashkisë, do realizohet duke respektuar instucionet e varësisë por dhe detyrimet e taksat që lindin si pasojë e veprimtarisë së OE si dhe për të garantuar një pjesëmarrje efektive të ofertuesve në këtë prokurim publik, me qëllim lehtësimin e situatës konkurruese të tyre, nuk mund të ketë pjesëmarrje nga subjekte të cilat nuk kanë kryer shlyerjen e detyrimeve të taksave lokale.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 2.3 Kapaciteti teknik:

. 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 400 000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. ***Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të*

vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të perkthyer , origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor,**nr.16,datë.10.02.2023**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit"**, me fond limit prej: **2 108 500(dy milionë e njëqindë e tetë mijë e pesëqindë) lekë pa tvsh,, lloji i procedurës: “E Hapur Thjeshtuar”**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Anëtarët pranuan specifikimet teknike/ preventivin të hartuara nga Komisioni i posacëm :KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.727,datë 03.02.2023,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për shërbimet/mallrat që do të blejë. Për sa i përket specifikimeve teknike komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer nëpërmjet tre ofertave. Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të gjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në baz të mesatares së ofertave ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.727/2prot.,07.02.2023 .

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit(E HAPUR E THJESHTUAR) është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 49, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin 11, pika 1, gërma b dhe neni 55.

:preventivat e shërbimeve janë hartuar nga specialistet e fushes konkretisht nga KLLFLST ,dorëzuar preventivi me procesverbalin e komisionit nr.727/1prot,datë 07.02.2023 dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave.

Preventivi I hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin: "Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit",

Shërbimet që kërkohen:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Kengetar	Persona	6
2	Vajza Myzeqare	copë	135
3	Qytetar Nderi	copë	20
4	Ftesa për të ftuarit	copë	300
5	Certifikata të ndryshme	copë	50
6	Shishe vaji Ulliri	copë	20
7	Canta robe për dhurata	copë	150
8	Simbole të bashkisë	copë	30
9	Dreka për të ftuarit	Persona	400
10	Kartolina	cope	300
11	Kupa 24 Korriku	cope	2

12	Medalje	cope	4
13	Sapune	cope	50
14	kulinarizem	Persona	10
15	Juria e vlersimit	Persona	30
16	Vlersim per fituesit	Persona	10
17	Skena	cope	1
	SHUMA		
	TVSH		
	SHUMA ME TVSH		

Afatet e ekzekutimit: Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës mbaron deri më 31.12.2023 ,sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1- Këngëtarë ,Sasia 6(gjashtë) persona

Në kuadër të festave lokale si festa ``24 Korrikut `` në muajin Korrik , ``Festa e Ullirit ``në muajin Tetor dhe ``Njeriu i Vitit ``në muajin dhjetor, për cdo aktivitete na nevojitet nga 2 (dy) këngëtarë .

2-Vajza Myzeqare ,Sasia 135 (një qind e tridhjetë e pesë) copë

Materiali Bronz , bashkëngjitur do të gjeni foto të modelit .

3-Qytetar Nderi, Sasia 20 (njëzetë) copë .

Qytetar Nderi sipas modelit të fotos bashkëlidhur

4- Ftesa për të ftuarit ,Sasia 300 (treqind) copë .

Materiali karton dhe te specifikuar sipas festave ``24 Korrikut `` në muajin Korrik , ``Festa e Ullirit ``në muajin Tetor dhe ``Njeriu i Vitit ``në muajin dhjetor dhe dizanj.

5-Certifikata të Ndryshme ,Sasia 50 (pesëdhjetë)copë .

Material kartoni në formatin A4

6-Shishe vaj Ulliri , Sasia 20(njëzetë) copë .

Material qelq , me etikë me logon e Bashkisë Roskovec si edhe me tapë . Në masën 750 ml .

7-Canta rrobe,Sasia 150 (një qind e pesëdhjetë) copë .

Canta është material rrobë 25 cm e gjerë dhe 30 cm e gjatë , ngjyrë bezhë dhe me logon e bashkisë . Bashkëngjitur do të gjeni edhe foto të modelit .

8-Simbole të Bashkisë ,Sasia 30 (tridhjetë) copë .

Sipas fotos bashkelidhur

9-Kartolina , Sasia 300 (treqind)copë .

Materiali karton+dizanj .

10-Kupa 24 Korriku , sasia 2 (dy) copë .

Në kuadër të festës së 24 Korrikut , organizohet edhe kupa 24 Korriku për skuadrën fituese .Bashkëngjitur edhe modelin e kupës /

11-Medalje ,Sasia 4 (katër)

Në kuadër të festës së 24 Korrikut , jepen medalje për fituesit ..Bashkëngjitur edhe modelin e medaljes .

12-Sapunë , Sasia 50 (pesëdhjetë) copë

Sapunë organik të prodhuar me mbetjen e ullirit si dhe me veshje të plotë dhe me etiketë ku të jetë shkruajtur dhe se me cfare arome është sapuni i prodhuar

13-Kulinarizëm ,Sasia 10(dhjetë)persona .

Vlersim për personat që do të angazhohen për gatimet tradicionale, vlера duhet te jete e pandryshuar, (2000)

14-Juria e Vlerësimit , Sasia 30 , (tridhjetë) persona .

Shpërblim për jurin e vlersimit për 10 titujt për aktivitetin “Njeriun e Vitit” Vlера është e pandryshuar,(5000)

15-Vlerësim për fituesit , Sasia 10 (dhjetë)persona .

Vlersimi për10 titujt për aktivitetin “Njeriun e Vitit” . Vlера është e pandryshuar. (5000)

16-Skena

Skena do të përdoret për aktivitetet e`24 Korriku ``.Skena duhet të jetë standarte dhe duhet të ketë ndricim të përfshirë .

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit e ngritur me urdhër prokurimi nr.16,datë 10.02.2023të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Znj Majlinda Bufi, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: